



Republika e Kosovës

Komuna e Vushtrrisë

Drejtoria për Arsim

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Ligji për Arsimin në Komuna Nr. 03/L-068 të vitit 2008, nenit 62 pika 62.2 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe Programit të Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2011, Drejtoria për Arsim paraqet:

Raportin e punës për vitin 2011.

Drejtoria për Arsim, për periudhën janar – dhjetor 2011, punët dhe detyrat e veta i ka bazuar në Ligjin mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë Nr.2002/2, në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Ligji për Arsimin në Komuna Nr. 03/L-068, në Programin e punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2011 dhe në Programin e punës së DKA-së për vitin 2011.

Në këtë raport paraqiten nivelet e organizimit të shkollimit, realizimi i projekteve, të arriturat dhe vështirësitë që na kanë përcjellë gjatë kësaj periudhe kohore.

I. Nivelet e organizimit të mësim

Mësimi në shkollat e komunës realizohet në dy ndërrime dhe në hapësirë të mjaftueshme. Mësimi në komunë zhvillohet në:

- Institucion parashkollor, çerdhja e fëmijëve “Foleja” në Vushtri.
- Shkolla e ulët e muzikës me 43 nxënës.
- Në tri shkolla fillore (nga klasa e parë deri të pestën).
- Në 24 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta (nga klasa e parë deri në klasën e nëntë) me 20 paralele të ndara fizike.
- Në 2 shkolla të mesme të ulta (nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë)dhe
- Në tri Shkolla të Mesme të Larta.(gjimnazi, Shkolla e Mesme e lartë Teknike dhe Shkolla e Mesme Profesionale)

II. Realizimi i projekteve gjatë vitit 2011.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar këto projekte:

- Është realizuar projekti i transportit të nxënësve të cilët janë në distancë të largët nga shkolla, në 30 relacione.

1. Karaçë-Vushtri, 2. Kollë Vërrnicë, 3. Nemozhë-Mihaliq 4. Liqej- Akrahticë, 5. Kollë-Brusnik – Novolan, 6. Gumnishtë- Skromë, 7. Sllakoc-Ceceli, 8 Strovç- Stroc. 9.Studime e Epërme - Vushtri 10. Sfaracak i Epërm– Vushtri, 11. Shallc-Druar.

12. Beçuk- Stroc, 13 Mihaliq-Mihaliq, 14. Zagoria –Lumni Surdulli, 15. Dumnicë e Epërme-Bajram Curri, 16. Shalle-Vërrnicë, 18 Novolan i Poshtëm –shkolla “Emin Duraku”, 19. Lagjja Murati-Stroc, 20. Ropicë –sh. “Rilindja”, 21. Galicë- sh.”Azem Bejta”, 22. Sfaracak-Nadakoc, 23.Liqej-Bukosh-Vushtrri, 24.Lagjja Zenaj, Zeqiri - sh “Rilindja”, 25. Balincë-Aktashticë, 26. Banjskë-Smrekonice , 27.Lagjja Zabërxha Samadrexhë, 28.Studime e Poshtme-Vushtrri, 29. Sfaracak i Epërm- Studime e Poshtme, 30. Tërllabuq-Sh.“Adem Voca”,

- Janë furnizuar shkollat me material të nevojshëm higjienik dhe zyrtar
- Furnizimi me dru dhe thëngjill është bërë me kohë dhe cilësi të mirë..
- Janë meremetuar shkollat në:
 - Dobërlukë (dysHEMEJA, kanalizimi,ngjyrosja)
 - Novolan (ngjyrosja dhe dysHEMEJA).
 - Mihaliq (njejt sanitare, dysHEMEJA dhe ngjyrosja) me mjete të DKA-së dhe shkolla në Samadrexhë më bashkëfinancim të DKA-së dhe CDF-it (meremetimi komplet në vlerë 630.000.00 Euro)
- Në shkollat ku është rregulluar dysHEMEJA janë vendosur gomat në banka dhe karrige, për të mbrojtur dysHEMENË.
- Është instaluar ngrohja qendrore në shkollën “ Bahri Kuqi” kontribut i banorëve të fshatit dhe Tirolit Austriak, (me vlerë 12.000.00 Euro)
- Ka përfunduar ndërtimi i shkollës pesëklasëshe në Bukosh me mjete te DKA-së
- Ka përfunduar ndërtimi i fazës së parë të shkollës në Zhilivodë, kurse shkolla e vjetër është rrënuar dhe materiali ndërtimor është përdorur për ndërtimin e lokaleve ndihmëse për lëndë djegëse në shkollën e Gllotinit, Beçukut dhe nyjeve sanitare në Beçuk Gllotinit dhe te Berishtë.
- Në shkollat “Eqrem Çabej”. “G.J.S, Kastioti” “Azem Betja”, “Emin Duraku”, “Adem Voca”, “Lumni Surdulli” dhe shkolla e “Mihaliqit”, janë realizuar projektet e Bankës Botërore që kanë për qëllim ngritjen e cilësisë në arsim dhe po ashtu janë në vazhdim këto projekte për shkollat SHMU II>, “Lumni Surdulli” dhe në shkollën e Mihaliqit..
- Janë shpërnda tekste shkollore në të gjitha shkollat e komunës, donacion i MASHT.
- Janë pranuar kuadrat arsimore për vitin 2011/2012 sipas konkursit të shpallur në mjetet e informimit dhe në bazë të UA 19/2009
- Është mbajtur testi i arritshmërisë për klasa të IX dhe janë testuar 1475 nxënës në pesë qendra të testimit.
- Në institucionin parashkollor janë pranuar 160 fëmijë të moshave prej 1-5 vjeç.
- Në fillim të vitit shkollor 2011/2012 janë regjistruar 1285 nxënës në klasën e parë, në 64 paralele. Kështu që krahasuar me vitin e kaluar 47 nxënës janë më shumë.
- Janë regjistruar 43 nxënës në shkollën e muzikës “Tefta Tashko” paralele e ndarë në Vushtrri në këto drejtime: solfezhi 43, piano 17, klarinetë 7, Kitarë 9, Violinë 10.
- Të gjithë nxënësit të cilët kanë përfunduar klasën e dhjetë iu është mundësuar të regjistrohen në SHML sipas konkursit dhe kriterëve të MASHT.

III. Suksesi i nxënësve në fund të vitit shkollor 2010/2011 dhe rezultatet në testin e maturës shtetërore për vitin shkollor 2011

- Në Arsimin Fillor (1-5) me 324 paralele dhe 7037 nxënës, sukses pozitiv kanë treguar gjithsej 99.5% e nxënësve, kurse 0.5 sukses negativ.
- Në Arsimin e Mesëm të Ulët (6-9) me 232 paralele dhe 5563 nxënës, sukses pozitiv kanë treguar gjithsej 99.46% e nxënësve, kurse 0.54 sukses negativ.
- Në Arsimin e Mesëm të Lartë (10-13) me 131 paralele dhe 4318 nxënës, sukses pozitiv kanë treguar gjithsej 94.61% e nxënësve, kurse 5.39 sukses negativ.
- Rezultatet në testin e maturës shtetërore për vitin shkollor 2011
 - Në gjimnazin “Eqrem Çabej”, këtij testi i janë nënshtruar 529 nxënës dhe sukses pozitiv kanë arritur 446 nxënës ose 84.31 %, kurse sukses negativ 83 nxënës ose 15.69 %
 - Në SHMT “ Lutfi Musiqi” janë testuar 268 nxënës dhe me sukses pozitiv kanë dalë 121 ose 45.15 % dhe sukses negativ 147 ose 54.85 %
 - Në SHMP “ Bahri Haxha” janë testuar 214 nxënës, ku nga ta 83 janë pozitiv ose 38.79 dhe 131 negativ ose 61.21 %.

Analizuar në përgjithësi rezultatet e maturës për të tri shkollat e mesme të larta, del se, nga gjithsej 1011 nxënës të testuar në afatin e qershorit dhe gushtit, rezultat pozitiv kanë treguar 650 nxënës, shprehur në përqindje 64.29 %, kurse negativ 361 apo 35.71% .

IV. Aktivitetet tjera të DKA-së dhe shkollave

Në kuadër të aktiviteteve tjera janë paraqitur takimet me përfaqësues të ndryshëm të institucioneve shkollore , manifestimet dhe garat në nivel vendi etj.

- Takim me përfaqësuesit e kolegjit “Mehmet Akif” për organizimin e garave në nivel-vendi për lëndët Kimi dhe Gjuhë angleze për klasat e VII dhe IX, ku nxënësit e komunës sonë kanë treguar këto rezultate: për lëndën e kimisë mesatarja e pikëve ka qenë 32.23.%, kurse mesatarja e pikëve në nivel të Kosovës ishte 29.86 %, ndërsa për lëndën gjuhë angleze mesatarja e pikëve ka qenë 48.27.% , kurse mesatarja e pikëve në nivel Kosovës ishte 47.84% .
- Është mbajtur manifestim në rastin e 7 Marsit-Ditës së mësuesit, me ç’rast janë ndarë mirënjohje dhe nga një orë-dore për të gjithë punëtorët e arsimit që janë pensionuar gjatë periudhës mars 2010- mars 2011.
 - Drejtori i DKA-së dhe dy drejtorë shkollave janë pjesëmarrës në seminarin dyditor në Durrës “Sigurimi dhe Ngritja e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar” organizuar nga kolegji “Aga Xhitë”.
 - Në kuizin e diturisë organizuar nga ana e kolegjit “Aga Xhitë, nxënësja Leonora Drevinja e shf ”Latif Berisha” ka marrë vendin e parë në Republikën e Kosovë, e të cilës në ditën e çlirimit të Vushtrrisë iu është ndarë mirënjohje.
 - KFOR-i Francez ka furnizuar një klasë në SHFMU “Enver Hadri” me inventar shkollor (20 banka e 40 karrige) si dhe disa ndihma për shkolla tjera.
 - Është ngjyrosur hapësira e brendshme e SHFMU “Migjeni”, financuar nga DKA-ja dhe punuar nga punëtorët teknik të shkollës, në rastin e vizitës së Ambasadorit Japonez në këtë shkollë.

- Në garat sportive të mbajtura në Pejë, SHMU II ka zënë vendin e parë në nivel Kosovë, në basketboll si dhe vendin e tretë SHMLP.
- Në festën e Abetares, e cila është mbajtur në Pejë me datën 17.04.2011. Komuna e Vushtrrisë është përfaqësuar nga shkolla fillore” Naim Frashëri”.
- Janë përruruar firmat ushtrimore dhe kabineti i informatikës në SHML “ Bahri Haxha” donacione të DANIDA dhe Swiscontact.
- Është mbajtur mbledhja me drejtorët e shkollave dhe është formuar komiteti për parandalimin e dhunës në shkolla, organizuar nga MASHTI dhe KEC.
- Janë vizituar dy shkollat “ Ali Kelmendi” dhe “Enver Hadri” nga komisioni i MPL për gjendjen e shkollave dhe mënyrën implementimit të projektit për oficencë të energjisë ku DKA ka aplikuar për 4 shkolla (“Mustafë Venhari”, “Ali Kelmendi”, “Enver Hadri”, SHMT “Lutfi Musiqi”)
- KFOR-i Francez (Majorin Segard) ka siguruar 7 kontejnerë metalik për shkollat: “Nim Frashëri”, Ashlani, Dobërlukë, Mihaliq, Resnik. Migjen-2, në të cilët kontejnerë janë vendosur lëndët djegëse.
- Është nënshkruar memorandumi i mirëkuptimit për themelimin e Qendrës për Ngritje Profesionale nga kryetari i komunës, përfaqësuesi i USAID-it drejtori i DKA-së dhe drejtori i shkollës SHMU II në Vushtri.
- Është mbajtur konferenca dyditore 27-28 prill 2011 në Prishtinë, <Arsimi për të rritur, arsimi joformal dhe trajnimi>, faktor kyç për zhvillimin e ekonomik dhe social në Kosovë”.
- Është organizuar pritje e delegacionit të turqve nga HOLANDA, të cilët kanë financuar në ngjyrosjen e shkollës në Studime të Poshtme, kanë ndërtuar kopshtin me lojëra të fëmijëve dhe kanë bërë pagesën e radiatorëve për ngrohje qendrore me vlerë 1500.00 euro për këtë shkollë. Kanalizimi në shkollë është realizuar nga mjetet e shkollës.
- Është realizuar shëtitje më nxënësit e klasave të nënta në këtë itinerar(udhërrëfyes) Vushtri-Prekaz-Trofta-Guri i Zi-Prizren dhe kthimi për Vushtri, e cila ka kaluar pa probleme.
- Është organizuar pritje e delegacionit të Tirolit që kanë realizuar projektin e ngrohjes qendrore në shkollën “Bahri Kuçi” me vlerë 12.000.00. euro
- Shkolla “Naim Frashëri “ është përfituese e projektit nga BEP, për klasën e shekullit XXI ku me ndihmën e prindërve dhe DKA-së është renovuar një klasë (ngjyrosur, ndërrimi i dritareve, ngjyrosja e inventarit dhe adaptimi për kushte të projektit). kurse me organizimin e drejtoreshës me prindërit e shkollës, janë ngjyrosur edhe 14 klasë tjera.
- Është mbajtur mbrëmja e filmit arsimor në shtëpinë e kulturës nga BEP dhe një koktej rasti financiar nga BEP, ku ishin të pranishëm 200 mësimdhënës dhe kryetari i këshillit të prindërve.
- Është mbajtur takim i Komisionit Shtetëror të Maturës, dhe DKA e Vushtrrisë ka marrë pjesë me 600 administrues në tërë vendin.
- Është raportuar para grupit qeveritar për riatdhesimin e qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë. Grupi qeveritar është përbërë nga përfaqësuesit e tri ministrive: Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Integritimit Evropian dhe MASHT.

- Është organizuar darka tradicionale me të gjithë mësime të komunës në hotel Amazona në rastin e përfundimit të procesit mësues ku ishte i pranishëm edhe kryeministri i Republikës së Kosovës z.Hashim Thaqi
- Është kremtuar dita e çlirimit të komunës dhe janë ndarë mirënjohje nga Kuvendi për punëtorët e dalluar të arsimit.
- Është mbajtur konkursi “ Gjuhëtari i ri” në Institutin Albanologjik dhe shkolla fillore dhe e mesme e ulët “Bahri Kuqi” ka zënë vendin e parë me meritën e nxënëses Vjendita Pllana.
- Është organizuar pritje e delegacionit nga Turqia, të cilën e ka udhëhequr drejtori komunal i arsimit dhe kryetari i shoqatës Shkup-Kosovë Rexhep Gundy. Delegacioni ishte i përbërë prej 12 anëtarësh të cilët janë vendosur në hotel Amazona. Këtë delegacion e ka shoqëruar Nashit Drejta nga DKA, Musa Tërbunja dhe drejtorët e shkollave që janë vëllazëruar: Valbona Drejta, Kadrije Miniqi dhe Isak Bajrami. Katër shkollave të vëllazëruara iu është sjellur nga një laptop nga delegacioni turk.
- Ju është bërë pritje nxënësve shqiptarë nga Gjermania qyteti Osnabryk (42 nxënës dhe 4 profesorë) që në kuadër të programit <Ekskuzioni mësues njohës me Kosovën> kanë qëndruar një natë në Vushtrri. Pritja është bërë në SHMU II. Është organizuar program nga shkolla, mandej darka dhe programi festiv është mbajtur në hotel Amazona, nxënësit e kanë kaluar natën në familjet e nxënësve Vushtrrias.
- Është mbajtur konferenca “Vizioni për maturën 2015 në Kosovë” organizuar nga MASHT dhe financuar nga Banka Botërore.
- Prej datës 27 11.2011 deri me datën 30 11.2011 është realizuar vizita me delegacionin e DANIDA, MASHT dhe shkollat bujqësore të tri komunave në Greqi, në shkollën Bujqësore Amerikan në Selanik. Gjatë kësaj vizite janë analizuar përvojat e kësaj shkolle.
- Janë mbajtur takime me MASHT ku janë analizuar konkluzionet e Konferencës për Maturë 2011 dhe mundësitë e ndryshimit në të ardhmen.
- Janë mbajtur takime me zv.ministrin e Ministrisë së Pushtetit Lokal, për gjetjen e mënyrës dhe futjes së komunitetit serb në sistemin e Arsimit të Republikës së Kosovës.
- Është mbajtur trajnimi tregues nga MASHT, KEC, një takim me Elazibet Gowing në DKA për “Mjetet Planifikuese në Arsim”
- Vizita e delegacionit të komunës në Bursa të Turqisë (Musa Tërbunja, Isak Bajrami, Valbona Drejta, Ganimete Selimi Syzana Syla, Sanije Spahiu, Mevlude Idrizi, H. Muli) Shpenzimet e udhëtimit nuk janë mbuluar nga DKA por nga vetë-anëtarët e delegacionit. Për shkollat “A.Z.Ç” dhe “Ali Kelmendi” është dhuruar nga një projektor, kurse për shkollën “Naim Frashëri” një TV plazma.

V. Trajnimet e organizuara nga MASHT-i

- Janë mbajtur trajnime me të gjithë drejtorët e shkollave, zyrtarët e buxhetit dhe nga një mësues për planifikimin e buxhetit në shkolla.

- Janë mbajtur trajnime me të gjithë drejtorët e shkollave, zyrtaret e buxhetit dhe nga një mësimdhënës për procedurat e prokurimit në shkolla.
- Me të gjithë drejtorët janë mbajtur trajnime për statistika të shkollave.

VI . Vështirësitë gjatë kësaj periudhe kohore

- Një numër i madh i mësimdhënësve me sëmundje kronike,
- Organizimi i kurseve private nga ana e mësimdhënësve të pandërgjegjshëm.
- Numër i vogël i nxënësve në disa paralele të ndara,ntë shkolla ku mësimi zhvillohet me klasë të kombinuara (Beçuk, Berishë, Karaçë, Skromë Gumnishtë, Studime e Epërme dhe Sllatinë)
- Mungesa në fusha sportive,
- Mungesa e kabineteve të informatikës;
- Mungesa në laboratorë të kimisë, fizikës, biologjisë

VII. Përfundimi

Në bazë të realizimit të projekteve, suksesit në procesin mësimor, rezultateve në testin e maturës, aktiviteteve të shkollave dhe DKA-së, vizitave nga delegacionet e jashtme dhe trajnimeve organizuar nga MASHT-i, mund të përfundojmë se gjatë këtij viti kalendarik janë plotësuar objektivat e DKA-së.